

- **Neni 9** – (aline 1 pika 5) Ndhimë në të holla me lartësi të shpensimeve reale për varrim, por më së shumti deri në tre rroga mesatare neto në muaj për të punësuar të paguara në Republikën e Maqedonisë në muajin e fundit para se të vdesë, sipas të dhënave të Entit shtetëror për statistikë, që i paguhen familjes së personit që ka ndrruar jetë prej të cilit janë marë pjesë nga trupi i njeriut për shërim. Ndhimën në të holla nga aline 1) pika 5 e këtij neni e siguron Ministria e shëndetësisë nga programi që ka të bëjë me marjen e pjesëve të trupit të njeriut për shërim, sjellur në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtje sdhëndetësore.
- **Neni 13** – Të dhënat personale të personit prej të cilit janë marë pjesë nga trupi i njeriut, si dhe ato që kanë të bëjnë me pranuesin llogariten për informacione rreptësisht të besueshme dhe ruhen në pajtueshmëri me dispozitat për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të të dhënave personale.
- **Neni 15** – Organ apo ind i trupit të dhuruesit të gjallë mund të merret me transplantim vetëm për shkak të shërimit të pranuesit, nëse nuk ekziston organ adekuat apo ind nga perosni i vdekur dhe nëse nuk ekziston tjetër, përafërsisht metodë e njëjtë e shërimit, përveç në rastin e palcës kockore.
- **Neni 26** – (1) Pjesë të trupit të personit të vdekur mund të merren për shkak të transplantimit pasi me siguri, në bazë të kriterëve mjekësore dhe mënyrë së rregullt është vërtetuar se është konstatuar vdekja tek ai person. (2) Vdekje në kuptim të alinesë (1) të këtij neni paraqet ndërprerje të pakthyeshme të funksionit të trurit të vërtetuar me kontrollime klinike.



A E DINI SE

Në Republikën e Maqedonisë tani më shumë vite me transplantim shpëtohen nga disa jetë apo përmirësohet jeta e pacientëve, por nevoja për të është dhjetë herë më e madhe. Për fat të keq, shumë pacientë tek të cilët ka ardhur deri në ndërprerjen e të funksionuarit të përhershëm të organeve të caktuara vdesin apo përgjithëmonë shërohen me procedura të rënda terapeutike.

MENDONI NË ATË SE

Ndoshta të nesërmen anëtarë të familjes tuaj, miq tuaj, apo ndoshta edhe ju vetë do të keni nevojë të domosdoshme për organ të dhuruar.

BISEDONI

Me familjen dhe miqt tuaj për vendimin dhe përgatitshmërinë tuaj pas vdekjes suaj të ndihmoni që të shpëtohet jetë tjetër të cilët kanë nevojë për ato.

PYETNI

Nëse dëshironi të dini më tepër për temën e vërtetë të dhurimit të organeve, Ju mundeni të merni informata plotësuese infoservisin DHURIMI I ORGAN-EVE duke thirur në numrin 02/322 58 99

WWW.REDCROSS.ORG.MK

www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

www.youtube.com/MacedonianRedCross

DHURONI ORGAN DHURONI JETË

Çka është dhurimi i organeve

DHURIMI I ORGANEVE është procedurë e **DHURIMIT** të organeve, indeve ose qelizave nga një person i gjallë apo i vdekur, me qëllim të transplantimit në trupin e personit tjetër për shkak të shërimit. Donacioni është në mënyrë vullnetare dhe pa kompensim financiar.

Cilat organe dhe inde transplantohen zakonisht

- **Veshkët**, për të eliminuar nevojën për dializë
- **Pankreasi**, për të eliminuar nevojën për insulinë
- **Mëlqia, mushkëritë, zemra, ose zorrët e holla**, kur trupi nuk është në gjendje të mbijetesës së mëtutjeshme të pacientit
- **Palca**, e cila përdoret për ripërtirjen e qelizave të gjakut gjatë situatave të caktuara dhe pas terapisë antikancerogjene
- **Lëkura**, për trajtimin e djegieve të rënda dhe dëmeve tjera
- **Valvulat e zemrës apo arteriet**, në kushte të caktuara
- **Eshtrat**
- **Kornea**, kur kjo shtresë mbrojtëse e syrit është i lënduar për shkak të intervenimit katarakt ose trauma



Kur një person mund të dhuron organe dhe inde ?

Secili prej nesh, nëse i plotëson kushtet mjekësore, mund të dhurojë veshkë, pjesë prej mëlqisë ose mushkërive, qeliza palcore dhe lëkurë

Dhurues i organeve mund të jetë pacienti i cili ka pësuar sulm në tru. Ai mund t'i dhurojë veshkët, mëlqinë, zemrën, mushkëritë, zorrët e holla dhe inde tjera. Donacioni i organeve në këtë rast është i mundshëm atëherë kur një ekipë mjekësore profesionale do të vërteton se pacienti ka pësuar vdekje truri.



Kur mund të dhurohen organet ?

Kur mjekët do të vërtetojnë se ka ndodhur vdekje truri, organet fillojnë të mbahen në jetë me ndihmën e aparateve. Në disa orët e ardhshme, ato patjetër duhet të arrijnë në mënyrë adekuate tek personat të cilët duhet t'i pranojnë. Marrja e organeve nuk do të ndodhë derisa:

- Nuk plotësohen të gjitha kushtet mjekësore
- Personi tek i cili është vërtetuar vdekje e trurit ka nënshkruar deklaratë se nuk dëshiron të jetë dhurues i organeve
- Derisa familja e dhuruesit nuk pajtohet që organet e tij të donohen.

A është me rëndësi gjendja shëndetësore në procedurën e dhënies së organeve?

- Po, është i rëndësishëm vlerësimi i gjendjes shëndetësore!
- Dhurimi i organeve gjatë jetës nuk duhet ta rrezikojë jetën e dhuruesit e as ta dëmton shëndetin e tij.
- Gjatë dhurimit të organeve nga personi i vdekur organet dhe indet duhet të jenë në gjendje të mirë.

A është e definuar qartë procedura e donacionit të organeve dhe transplantimit?

Në të gjitha vendet Evropiane, dhurimi i organeve është e rregulluar me ligj. Në Republikën e Maqedonisë është sjellë Ligji për transplantimin e organeve dhe indeve për shkak të mjekimit, që është në pajtueshmëri me të gjitha rregulloret Evropiane. Procedura e transplantimit në tërësi është e definuar në mënyrë të qartë dhe precize. Do të zbatohet në ente mjekësore të specializuara nga personat profesional, në bashkëpunim me laboratoritë të akredituar. Do të ndërmerren të gjitha masat që për ta ruajtur anonimitetin e dhuruesit dhe pranuesit të organit dhe do të respektohen vendimet ligjore.

Çfarë duhet të bëjmë për tu bërë dhurues?

Keni vendosur të bëheni dhurues njoftoeni familjen e juaj për këtë vendim. Gjatë jetës tuaj duhet të bisedoni me të afërmit e familjes dhe me shoqërinë tuaj. Qartë ta shprehni dëshirën për dhurimin e organit apo indit. Nëse familja e din vendimin tuaj, do të mundet ta plotëson dëshirën e juaj.



Nga Ligji për marrjen dhe transplantimin e pjesëve të trupit të njeriut për shkak të shërimit (Gazeta zyrtare e RM- së nr. 47 nga 08.04.2011)



- **Neni 3-** (1) Marrja e pjesëve të trupit të njeriut për shkak të shërimit mund të bëhet vetëm në procedurë dhe kushte të vërtetuara me ligj. (2) Marrja dhe transplantimi i pjesëve të trupit të njeriut për shkak të shërimit mund të bëhet vetëm kur është e arsyeshme sipas mjekësisë, kur ajo është mënyra më e volitshme për shërimin e të sëmurit, kur nuk e rrezikon jetën e dhuruesit ose nuk i shkakton dëm të përhershëm shëndetit, në procedurë dhe në kushte të paraparë me këtë ligj.
- **Neni 4** – (1) Ky ligj është i bazuar në parimet e solidaritetit, drejtësisë, qasje dhe ndalesë të barabartë të diskriminimit, arsyetim mjekësor për marrjen dhe transplantimin e pjesëve të trupi të njeriut, sigurim, autonominë e dhuruesve dhe pranuesve të organeve dhe indeve, si dhe parimin e ndërgjegjës dhe ndershmërisë.
- **Neni 5** – (1) Në zbatimin e procedurave për marrjen dhe dhënien e pjesëve të trupit të njeriut për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, respektimin e dinjitetit dhe liritë themelore të njeriut.
- **Neni 7** – Dhurimi i pjesëve të trupit të njeriut ju dhurohet pranuesve në mënyrë që të sigurohet qasja e barabartë te pranuesit nga pritja e Listës kombëtare dhe në pajtueshmëri të kriteriumeve mjekësore transparente, objektive dhe etike.
- **Neni 8** – (1) Dhurimi i pjesëve të trupit të njeriut për shkak të transplantimit është vullnetar dhe pa kompenzim. (2) Është e ndaluar për të dhënë kompenzim në të holla ose ndonjë përfitim tjetër për dhurimin e pjesëve të trupit të njeriut.